

Dalës-izdava

Nr. 11-456  
Br.

Data 27.04.2022  
Datum



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E OBILIÇIT  
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



Në mbështetje të nenit 73 të Statutit të Komunës, nenit 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, Ligjit nr. 05/L-092 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237 dhe me Ligjin nr. 05/L-608, dhe kërkesës së Zyrës së Prokurimit nr.XIII-75 të datës 26.04.2022, Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

### VENDIM

- I. Formohet komisioni për vlerësimin e ofertave për aktivitetin e prokurimit **“Asfaltimi i rrugëve në Dardhishtë seg. 1-2 dhe rruga “Hasan Prishtina” seg.1 Rishpallje** : me nr. të prokurimit 614 22 003 521, në këtë përbërje:
  1. Leonarda Emini - Kryetare
  2. Blinera Bërbatovci - Anëtare
  3. Kushtrim Mirena - Anëtar
- II. Anëtarët e komisionit duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshmërisë siç janë specifikuar për anëtarët e stafit të Divizionit të Prokurimit në neni 23.3 të LPP-së, do të nënshkruajnë deklaratën me shkrim dhe i nënshtrohen dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të biznesit.
- III. Komisioni do të funksionojë nga dita e miratimit të vendimit për krijimin e komisionit deri në përmbushjen e të gjitha detyrave të përcaktuara nga autoriteti kontraktues.
- IV. Komisioni, në fund të detyrës së tij, do të përgatisë një rekomandim për Zyrtarin e Prokurimit së bashku me një raport mbi punën e komisionit dhe një deklaratë të arsyeve mbështetëse për rekomandimin.
- V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ti dorëzohet:

- Anëtarëve të komisionit;
- Zyrës së prokurimit;
- Arkivës.

